



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 169/25 Dt. 10.03.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

- Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e pjesëmarrjes së Komunës së Prizrenit-DTZHE në “Panairin Ndërkombëtar të Turizmit 2025” që mbahet në Prishtinë, nga data 10 prill 2025 deri me 11 prill 2025, si dhe mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në këtë panair. Kështu që, i lejohej Komunës së Prizrenit- DTZHE, pjesëmarrja në këtë panair si dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të pjesëmarrjes lejohen mjetet financiare për:
 - Pagesën e hapësirës ekspozuese, të stendës, vitrinë, tavolinë, etj. në shumën prej 2070.00 € (dymijë e shtatëdhjetë euro). Paga i bëhet Unionit të Turizmit të Kosovës.
 - Mbulimin e shpenzimeve të ushqimit për stafin e DTZHE-së,
 - Angazhimin e makinës zyrtare për bartjen e stafit vajtje-ardhje për 2 ditë dhe bartjen e materialeve dhe broshurave promovuese,
- Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
- Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

